



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 2521/21; Datë: 10.09.2021

Në bazë të nenit 47, paragrafi 1.1 si dhe nenit 155, paragrafi 10 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur më 10.09.2021, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelit akademik në UShAF.

II.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të harmonizimit të rregulloreve me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Kryesuesi i Senatit

Nr. prot.: 2521/21; Datë: 10.09.2021

Prof. Dr. Agron Bajraktari, rektor i UShAF

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 155, paragrafi 1 dhe 10 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Senati i UShAF në mbledhjen e datës 10.09.2021, miratoi:

R R E G U L L O R E

PËR PROCEDURAT PËRZGJEDHËSE LIDHUR ME EMËRIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për zgjedhëse dhe procesin për emërimin e personelit akademik, në thirrjen profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistentë, ligjërues dhe lektor në të gjitha Fakultetet e UShAF.
2. Çështjet, që nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore në Statutin e UShAF lidhur me procedurat vlerësuese për emërimin e personelit akademik, rregullohen në dispozitat vijuese të kësaj Rregulloreje.

A.B.

Neni 2

Personeli akademik

Në pajtim me nenin 156, paragrafi 1, të Statutit të UShAF, personeli akademik i UShAF përbëhet nga: Profesorë të rregullt, Profesorë të asocuar, Profesor asistent, Ligjërues dhe Lektor.

Neni 3

Kriteret për emërimin në thirrje akademike

1. Procedura vlerësuese për emërim në thirrje akademike mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:
 - (1) Aktiviteti arsimor - Shtojca I;
 - (2) Aktiviteti hulumtues, shkencor dhe profesional - Shtojca II;
 - (3) Aktiviteti shërbyes - Shtojca III;
 - (4) Intervista dhe ligjërata testuese - Shtojca IV.
2. Për emërimin e kandidatëve në thirrjen përkatëse kërkohet plotësimi i minimumit të kriterëve të parapara në Statutin e UShAF, përkatësisht në shtojcat përkatëse të kësaj Rregulloreje.
3. Shtojcat I, II, III dhe IV janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Emërimi në thirrjen e Profesorit të rregullt

1. Në pajtim me nenin 157 të Statutit të UShAF, për titullin e profesorit të rregullt të Fakultetit, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Përfundimisht nga paragrafi 1.1 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për emërim në thirrjen profesor i rregullt, në mungesë të doktoratës grada Mr/MA i Arteve.
 - 1.3. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
 - 1.3.1. Së paku dy (2) monografi, (doktorata e publikuar njihet si një monografi)
 - 1.3.2. Së paku një tekst universitar si autorë i parë;

fb.

- 1.3.3. Së paku pesë punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuara në njërin nga pesë platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT¹, me Impakt Faktor IF>0.1 në kohën e publikimit të punimit, nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit;
- 1.3.4. Përfundimisht nga paragrafi 1.3.3 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për lëndët teorike së paku pesë punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuara në njërin nga pesë platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor IF>0.1, në kohën e publikimit të punimit, nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit. Ndërsa, për lëndët artistike së paku pesë aktivitete kryesore personale artistike ndërkombëtare të realizuara si autor i parë ose i vetëm, nga thirrja e fundit akademike. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, së paku pesë punime shkencore nga fusha përkatëse e studimit apo aktivitete artistike sipas përshkrimit më lartë, ku së paku një prej tyre të jetë punim shkencor dhe së paku një të jetë aktivitet personal artistik.
- 1.3.5. Pjesëmarrje aktive në së paku pesë (5) konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (të dëshmuara në njërin formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues), nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit
- 1.3.6. Përfundimisht nga paragrafi 1.3.5 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara pjesëmarrje në së paku tri (3) nga ekspozitë në galeri institucionale, garë, panair të produkteve dhe festival

¹ Udhëzim Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension

të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor si autorë i parë;

1.3.7. Pjesëmarrje në dy projekte ndërkombëtare;

1.4. Për lëndët e arteve figurative dhe muzikore duhe të ketë krijime ose punime të njohura artistike, të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit;

1.5. Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës;

1.6. Aftësi për udhëheqje akademike;

1.7. Të ketë udhëhequr të paktën 8 studentë MSc në tema të diplomave (Përfshijmë Fakulteti i Arteve të Aplikuara të paktën 3 studentë);

1.8. Të ketë qenë së paku 4 vite Prof. Asoc. Dr.

Neni 5

Emërimi në thirrjen e Profesorit të asocuar

1. Në pajtim me nenin 158 të Statutit të USHAF, për titullin e profesorit të asocuar, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;

1.2. Përfshijmë nga paragrafi 1.1 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për emërim në thirrjen Profesor i Asocuar, në mungesë të doktoratës, grada MSc/MA i Arteve.

1.3. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore (artistike për Fakultetin e Arteve të Aplikuara) për lëndën që dëshmohej me:

1.3.1. Së paku një (1) monografi, (doktorata e publikuar njihet si monografi)

1.3.2. Së paku tri punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuara në njërin nga pesë platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e



publikimit të punimit, nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit;

- 1.3.3. Përfshihet nga paragrafi 1.3.2 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara për lëndët teorike së paku tri punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuara në njërin nga pesë platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit, ndërsa për lëndët artistike së paku tri aktivitete të realizuara personale artistike ndërkombëtare si autor i parë ose i vetëm, nga thirrja e fundit akademike. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, së paku tri punime shkencore, nga fusha përkatëse apo aktivitete artistike sipas përshkrimit më lartë, ku së paku një prej tyre të jetë punim shkencor dhe së paku një të jetë aktivitet personal artistik.
- 1.3.4. Në Fakultetin e Arteve të Aplikuara pjesëmarrje në së paku dy ekspozita në galeri institucionale, gara, panaire të produkteve dhe festivale të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor si autorë i parë;
- 1.3.5. Të tregojë aftësi për mësimdhënie
- 1.3.6. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse

2. Të ketë qenë së paku 4 vite Prof. As. Dr.

Neni 6

Emërimi në thirrjen e Profesorit asistent

1. Në pajtim me nenin 159 të Statutit të UShAF, për titullin e profesorit asistent, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

- 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;

1.1.2

- 1.2. Përfshihet nga paragrafi 1.1 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për emërim në thirrjen Prof. Asistent, në mungesë të doktoratës, grada MSc/MA i Arteve.
- 1.3. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
- 1.3.1. Së paku një punim shkencor të publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuar në njërin nga pesë platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$, në kohën e publikimit të punimit, nga fusha përkatëse e studimit;
- 1.3.2. Përfshihet nga paragrafi 1.3.1 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara për lëndët teorike së paku dy punime shkencore të publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuar në njërin nga pesë platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit, ndërsa për lëndët artistike së paku dy aktivitete të realizuara personale artistike ndërkombëtare si autor i parë ose i vetëm, nga thirrja e fundit akademike. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, një punim shkencor, nga fusha përkatëse dhe një aktivitet personal artistik sipas përshkrimit më lartë.
- 1.3.3. Pjesëmarrje në së paku një konferencë ndërkombëtare, si prezantues oral i punimit si autor i parë, nga fusha përkatëse e studimit;
- 1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
- 1.5. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse;
- 1.6. Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve të Aplikuara.

A.B.

Neni 7

Emërimi në thirrjen e Ligjëruesit

1. Në pajtim me nenin 160 të Statutit të UShAF, për titullin e ligjëruesit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar së paku nivelin e dytë të studimeve (MA, MSc apo Magjistraturë)
 - 1.2. Kandidati i cili emërohet për herë të parë të ketë notën mesatare në studimet bachelor jo më të vogël se 7 dhe në studimet master jo më vogël se 8, ose notën 7.5 për studimet e sistemit 5 vjeçar të studimeve.
 - 1.3. Përjashtimisht nga paragrafi 1.2 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8.
 - 1.4. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
 - 1.4.1. Së paku një punim shkencor të publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, dhe indeksuara në njëërën nga pesë platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$, si autor i parë, nga fusha përkatëse e studimit;
 - 1.4.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1.3.1 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara për lëndët teorike së paku një punim shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe indeksuara në njëërën nga pesë platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit, si autor i parë, ndërsa për lëndët artistike së paku një aktivitete të realizuara personale artistike ndërkombëtare si autor i parë ose i vetëm.



- 1.4.3. Pjesëmarrje në së paku një konferencë ndërkombëtare, si prezantues oral i punimit si autor i parë, nga fusha përkatëse e studimit;
- 1.4.4. Përfshihet nga paragrafi 1.4.3 i këtij neni në Fakultetin e Arteve të Aplikuara pjesëmarrje në së paku një ekspozitë në galeri institucionale, garë, panair të produkteve dhe festival të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor si autorë i parë;
- 1.5. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
- 1.6. Të dëshmojë aftësi në punë me projekte shkencore/profesionale.

Neni 8

Emërimi në thirrjen e Lektorit

1. Në pajtim me nenin 161 të Statutit, për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
 - 1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
 - 1.3. Të ketë notën mesatare në studimet bachelor jo më të vogël se 8 dhe në studimet master jo më vogël se 8.
 - 1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;Të dëshmojë aftësi në punë me projekte shkencore/profesionale.

Neni 9

Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të UShAF dhe legjislacionit në fuqi



2. Procedurat dhe kushtet për revokimin e titujve, suspendimin apo ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të stafit përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga Këshilli Drejtues
3. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës, themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

Neni 10

Procedurat e konkursit

1. Procedura përzgjedhëse për emërim do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën përkatëse.
2. Konkursi për emërim shpallet me vendim të Senatit, pas kërkesës së Fakultetit dhe miratimit të Këshillit Mësimor/Shkencor.
3. Këshilli Mësimor/Shkencor nuk mund të kërkojë shpalljen në konkurs të pozitave, të cilat lidhen me personelin e rregullt, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.
4. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune, sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk ka të drejtë të aplikojë në konkurs meqë të njëjtit, me vendim të Rektorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.
5. Personelit të zgjedhur për pozitat sipas paragrafit 3 të këtij neni, i lëshohet kontrata e punës valide sipas së cilës mund të punoj deri në përfundim të vitit akademik nëse personeli pensionohet në vitin akademik të cilin e ka filluar.
6. Fakultetet, propozimet e tyre duhet t'i bazojnë në nevojat reale, numrin e mjaftueshëm të fondit të orëve që duhet të ketë një vend pune, për t'u zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit, ligjëruesit apo lektorit.
7. Propozimet për pozita të reja me normë të plotë mund të merren parasysh nëse Fakulteti ofron dëshmi që për atë pozitë ekziston fond i orëve:
 - 7.1. Për pozitë të mësimdhënësit, së paku 50% e orëve të parapara për normë të plotë duhet të jenë ligjërata nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ligjërata nga lëndët zgjedhore;
 - 7.2. Për pozitë të ligjëruesit apo lektorit, së paku 50% e orëve të parapara për normë të plotë të jenë ligjërata nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ligjërata nga lëndët zgjedhore.



8. Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozojë Senatit shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të caktuara të punës për personelin akademik, edhe nëse ai vend pune nuk është paraparë me propozimin e Këshillit Mësimor/Shkencor. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Statutit të UShAF dhe të kësaj Rregulloreje.
9. Konkursi shpallet në një gazetë ditore. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.
10. Punëdhënësi në sektorin publik, është i detyruar që një kopje të shpalljes së konkursit publik t'a dërgojë në Agjencionin e Punësimit të Republikës së Kosovës (MPMS).
11. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
12. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të UShAF (info@ushaf.net).

Neni 11

Komisionet Vlerësuese

1. Këshilli Mësimor/Shkencor, është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në Konkurs ta caktoj Komisionin Vlerësues.
2. Prorektori për Mësim, Shkencë dhe Çështje Studentore, jo më larg se 7 ditë nga mbyllja e konkursit thërret mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor, në të cilën merret vendimi për themelimin e Komisioneve Vlerësuese dhe Komisionit të Ankesave në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve për Komisione Vlerësuese dhe 3 (tre) anëtarëve të Komisionit të Ankesave.
3. Anëtar të Komisionit të Ankesave si dhe anëtarët e Komisioneve Vlerësuese, mund të jenë edhe strukturat udhëheqëse të Universitetit.
4. Komisioni Vlerësues propozohet nga radhët e profesorëve në nivel të Këshillit Mësimor/Shkencor të UShAF-it.
5. Komisionet Vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.
6. Komisioni Vlerësues përbëhet nga:
 - 6.1. një (1) anëtar, përfaqësues i rektoratit, i cili delegohet nga Rektori;
 - 6.2. një (1) anëtar, përfaqësues i dekanatit të fakultetit përkatës, i cili delegohet nga Dekani;



- 6.3. tre (3) anëtarë të lëmisë përkatëse, për të cilën aplikon kandidati, të cilët emërohen nga Këshilli Mësimor/Shkencor.
7. Nëse në UShAF nuk ka personel akademik të lëmisë përkatëse, atëherë kërkohet që ata të plotësohen nga universitetet publike të Kosovës.
8. Kryesues i komisionit është anëtari i deleguar nga Rektori.
9. Vlerësimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit Vlerësues është i barabartë (nga njëzet (20) pikë të vlerësimit të përgjithshëm prej njëqind (100) pikëve me një të pestën (1/5) apo njëzet për qind (20%) e pikëve të vlerësimit.
10. Në rast të arsyeve të bazuara, anëtari i Komisionit në afat prej pesë (5) ditëve pas formimit të Komisionit Vlerësues, mund të deklaroj me shkrim tërheqjen e tij nga Komisioni. Në këtë rast, anëtari zëvendësohet brenda shtatë (7) ditëve nga organi i cili e ka deleguar atë sipas paragrafit 6 të këtij neni.
11. Administrata e Fakultetit, duhet t'ia ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm Komisionit Vlerësues.
11. Kryetari i Komisionit Vlerësues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të Komisionit dhe të:
- 14.1 Shqyrtojnë aplikacionet e kandidateve;
- 14.2 Intervistojnë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit dhe vlerësojnë ligjëratën testuese;
- 14.3 Hartojnë raportin e vlerësimit për kandidatët.
12. Vlerësimin i kandidatëve bëhet në këto fusha:
- 16.1 Publikimet në revistat shkencore e bazuar në vlerësimin sipas Shtojcës II të kësaj rregullore.
- 16.2 Përvoja në mësimdhënie akademike.
- 16.3 Intervista.
- 16.4 Ligjërata testuese.
- 16.5 Aktivitetet tjera relevante duke përfshirë:
- publikimet tjera shkencore në revistat vendore dhe ndërkombëtare të cilat nuk janë të indeksuara sipas paragrafit A2 të Shtojcës II.
 - mentorimet e temave të diplomës bachelor.
 - mentorimet e temave të diplomës master.
 - mentorimet e temave të diplomës të doktoraturës.
 - pjesëmarrja në konferenca shkencore
 - pjesëmarrja në trajnime profesionale
 - përvoja e punës profesionale (jo akademike)
 - botimet e teksteve universitare
 - anëtar i organizatave profesionale
 - anëtar i komisioneve redaktuese në revista shkencore, dhe recensent në botimeve universitare, etj.

afj.

13. Komisioni Vlerësues është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas mbylljes së konkursit të dorëzojë raportin e vlerësimit për kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën e caktuar.
14. Anëtarët e Komisioni Vlerësues mund të zëvendësohen nga organi i cili e ka deleguar atë sipas paragrafit 6 të këtij neni nëse konstatohet nga Këshilli Mësimor/Shkencor se Komisioni nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë Rregullore, në lidhje me raportin vlerësues.
15. Pas ndryshimit të përbërjes së Komisionit Vlerësues, Këshilli Mësimor/Shkencor i jep afat komisionit të ri edhe dhjetë (10) ditë shtesë që të hartojë dhe ta dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.
16. Komisioni Vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e USHAF-it, këtë Rregullore, kushtet e Konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
17. Komisioni Vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor/artistik, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët e tjerë. Komisioni duhet të arsyetoj rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.
18. Në raportin e Komisionit Vlerësues, duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur.
19. Komisioni Vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet minimale por të cilët nuk janë propozuar të emërohen. Për kandidatët të cilët i nuk plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet të cilat nuk janë plotësuar.
20. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga të 5 (pesë) anëtarët, kryetari i Komisionit Vlerësues, është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Këshillin Mësimor/Shkencor.
21. Nëse ndonjëri nga anëtarët e Komisionit Vlerësues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për emërimin, e kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një "propozim të ndarë" për Këshillin Mësimor/Shkencor. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Statut dhe të detajuara në këtë Rregullore. Në raste të tilla, Këshilli Mësimor/Shkencor i diskuton të dy propozimet dhe e dorëzon në Rektorat propozimin që është miratuar nga Këshilli Mësimor/Shkencor, duke përfshirë informacionin për mendimet e ndara. Këshilli Mësimor/Shkencor mban të drejtën të refuzojë të dy propozimet, por nuk mund të miratojë të dy propozimet për të njëjtën pozitë.

A.B.

22. Në raportin e Këshillit Mësimor/Shkencor, duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs.
23. Anëtarët e Komisionit Vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Neni 12

Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni Vlerësues

1. Këshilli Mësimor/Shkencor, pas dorëzimit të raportit nga Komisioni Vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës, jo më vonë se shtatë (7) ditë, të shqyrtojë raportin dhe të konstatojë kryerjen e punëve në lidhje me raportin e Komisionit Vlerësues.
2. Këshillit Mësimor/Shkencor, pas mbajtjes së mbledhjes dhe konstatimit të gjendjes së raporteve vlerësuese, brenda tre (3) ditëve i përcjell raportet vlerësuese në verzionin elektronik pranë Administratës së Universitetit.
3. Universitetit është i obliguar që, për emërimet të personelit akademik, brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së raporteve vlerësuese nga ana e Këshillit Mësimor/Shkencor, të hartojë buletinet dhe të njëjtit t'i publikojë në ueb-faqen e Universitetit.
4. Buletinet duhet të qëndrojnë të publikuara në ueb-faqe të Universitetit, në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e publikimit.
5. Administrata e Universitetit, nëse konstaton se ndonjë nga raportet e dorëzuara nga Këshilli Mësimor/Shkencor nuk është në rregull me dokumentacion, atëherë duhet të kërkojë nga Prorektori për Mësim, Shkencë dhe Çështje studentore që ta obligojë Këshillin Mësimor/Shkencor që të kompletojë dokumentacionin para se të dalë në Buletin.
6. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve Vlerësuese në Buletine, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshillin Mësimor/Shkencor të UShAF-it.
7. Ankesat eventuale të kandidatëve duhet të dorëzohen në Administratën e UShAF-it.
8. Këshilli Mësimor/Shkencor, është i obliguar që pas kalimit të afatit të Buletineve, në afat prej dhjetë (10) ditëve, të vlerësojë raportet e Komisioneve Vlerësuese dhe të vendosë për miratim ose jo të atyre raporteve.



9. Gjatë shqyrtimit të raporteve, Këshilli Mësimor/Shkencor, është i obliguar që të shqyrtojë edhe raportin e Komisionit të Ankesave, lidhur me ankesat e kandidatëve të parashtruara në fazën e publikimit të Buletineve dhe ndaj ankesave të japë përgjigje me shkrim.
10. Këshilli Mësimor/Shkencor është i obliguar që, pas shqyrtimit dhe miratimit ose jo të raporteve të Komisioneve Vlerësuese, vendimin përkatës dhe detajet e tjera rreth shqyrtimit të ankesave t'i dorëzojë brenda tre (3) ditëve pranë Administratës së Universitetit.
11. Administrata e Universitetit, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar nga Këshilli Mësimor/Shkencor, është e obliguar që të informojë Prorektorin për Mësim, Shkencë dhe Çështje studentore dhe të kërkoj nga ai të kompletojë lëndët.

Neni 13

Shqyrtimi i propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor në Senat

1. Në një afat prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimi të propozimeve të Këshillit Mësimor/Shkencor, Administrata e Universitetit përgatitë për Senat pasqyrat me propozimet përkatëse, lidhur me propozimet e Këshillit Mësimor/Shkencor.
2. Vendimi i Senatit lidhur me propozimet e Këshillit Mësimor/Shkencor merret më së largu njëzet (20) ditë pas përgatitjes së pasqyrave nga Administrata e Universitetit.
3. Nëse Senati vendos ta refuzoj propozimin e Këshillit Mësimor/Shkencor, lënda përkatëse brenda tri (3) ditëve i kthehet për rishqyrtim Këshillit Mësimor/Shkencor.
4. Këshilli Mësimor/Shkencor obligohet që brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit të Senatit të rishqyrtojë lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës ta dorëzojë brenda tri (3) ditëve pranë Administratës së Universitetit.
5. Nëse Këshilli Mësimor/Shkencor, edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati në një afat jo më të gjatë se njëzet (20) ditë nga pranimi i propozimit, merr vendim përfundimtar.

Neni 14

Vendimi, periudha e ankimimit dhe kohëzgjatja e konkursit

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e Këshillit Mësimor/Shkencor, lidhur me emërimin e personelit akademik, bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.



2. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtrës, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimit në UShAF.
3. Konkursi për emërim të personelit akademik, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UShAF për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
4. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe në maksimum në 30 ditë.
5. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 3 të këtij neni, atëherë vendet përkatëse të parealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së Fakultetit.

Neni 15

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UShAF, nr. 2641/19, datë 01.08.2019.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesues i Senatit të UShAF
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI, Rektor



Shtojca I

FORMULAR PËR AKTIVITETIN ARSIMOR (MËSIMDHËNIE) DHE PROFESIONAL

Tabela I.1 Aktivitetet mësimore

Institucioni	Lënda/ët e ligjruar/a	Periudha		Niveli i studimeve (Bachelor/Master)
		Prej	Deri	

Tabela I.2 Mentorimi

Emri i kandidatit	Institucioni	Diploma / Niveli i studimit (Bachelor/Master/Doktoraturë) ²	Data e përfundimit

²Punimi i diplomës në studimet 5 ose 6 vjeçare, lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, konsiderohet ekuivalent me punimin e nivelit Master.

Tabela I.3 Pjesëmarrja nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët dhe punëtoritë

Nr	Konferenca/Kongresi/...	Vendi	Viti	Prezantim/Pjesëmarrje

Tabela I.4 Pjesëmarrja në trajnime profesionale

Nr	Lloji i Trajnimit	Vendi	Viti	Organizatori

Tabela I.5 Përvoja profesionale (jo-akademike)

Institucioni	Pozita	Periudha		Shënime tjera
		Prej	Deri	

Tabela I.6 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, etj.

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese	Viti

Tabela I.7 Anëtarësimi në organizata/institucioni profesionale

Nr	Organizata/Institucioni	Lloji i anëtarësisë	Viti i anëtarësimit	Shtëpia botuese	Viti

Tabela I.8 Pjesëmarrja në komisione redaktuese të botimeve universitare, revistave shkencore, konferencave, etj.

Nr	Libri/Publikimi	Autori/redaktori përgjegjës	Viti

Tabela I.9 Recensent në botime universitare

Nr	Libri	Autori	Shtëpia botuese	Viti

Shtojca II

FORMULAR PËR AKTIVITETIN HULUMTUES, SHKENCOR DHE PROFESIONAL

A. Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare dhe aktivitetet artistike

Tabela I.1 Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues	Impakt faktori

Tabela I.2 Aktivitetet artistike

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i aktivitetit	Lloji i ngjarjes	Karakterit	Linku identifikues

B. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare ose vendore që nuk përfshirë në tabelën A.1 (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.1 Publikimet në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

Tabela II.2 Aktivitetet tjera artistike.

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

Tabela II.3 Publikimet në revista akademike ose shkencore vendore.

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

C. Aktiviteti tjetër kërkimor - shkencor

Tabela II.4 Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Nr	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Viti, Vendi

D. Kontributi në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Tabela II.5 Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

N r	Programi/ projekti shkencor	Periodha kohore	Institucioni/ Vendi	Pozita në program, projekt/ Kontributi

E. Patente në nivel ndërkombëtar ose kombëtar

Tabela II.6 Patentet zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar

N r	Autorët (renditja si në patentin e zyrtarizuar)	Titulli i patentit	Institucioni/ Vendi, Viti i zyrtarizimit	Faqet

Shtojca III

FORMULAR PËR AKTIVITETIN SHËRBYES

Kjo shtojcë përfshinë aktivitetin në shërbim të Universitetit, Fakultetit dhe Komunitetit nëpërmjet shërbimit specifik përkatësisht pjesëmarrjes në komitete/komisione akademike, administrative ose ekipe profesionale.

Tabela III.1 Shërbimi në lidhje me Universitetin

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë shërbimit

Tabela III.2 Shërbimi në lidhje me Universitetin

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë shërbimit

Tabela III.3 Shërbimi në lidhje me Komunitetin

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë shërbimit

Shtojca IV

FORMULAR PËR INTERVISTIMIN DHE LIGJËRATËN TESTUESE

Kjo shtojcë përfshinë kategorite kryesore (dhe jo vetëm) e vlerësimit gjatë intervistës dhe ligjëratës testuese të kandidatëve për mësimdhënës.

Tabela IV.1 Intervistimi

Nr.	Lloji i vlerësimit
1	Komunikimi i rrjedhshëm
2	Eksperienca akademike
3	Relevanca me lëndët për të cilat ka konkurruar
4	Kapaciteti dhe aspiratat hulumtuese
5	Aftësi pune në grup me kolegë në programe, hulumtime, projekte....
6	Aftësi komunikimi dhe kooperimi me studentë.
7	Njohja me USHAF
8	Etika/Vetëkritika
9	Motivimi/Iniciativa
10	Fleksibiliteti

Tabela IV.2 Ligjërata testuese

Nr.	Lloji i vlerësimit
1	Objektiva e ligjëratës testuese është paraqitur qartë
2	Titulli dhe përmbajtja e ligjëratës testuese përputhen me njëri-tjetrin
3	Ligjërata testuese ka një kuptim të qartë dhe logjik
4	Prezantimi gojor është i qartë dhe i kuptueshëm
5	Ligjërata ofron mundësinë e interakcionit me audiencën
6	Prezantimi është i qartë dhe i ilustruar si duhet
7	Prezantuesi përdorë mirë pajisjet prezantuese
8	Prezantimi është i përfunduar mirë në kohën e dhënë
9	Dukja vizuale e prezantuesit (Garderoba, flokët, etj)
10	Gjuha e trupit